



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (Nismë deputetësh) *(Komision për dhënie mendimi)*

Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (Nismë deputetësh) *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Egllantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Robert Bitri, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Lefter Koka, Rahman Rraja, Kujtim Gjuzi dhe Gjetan Gjetani.

Të ftuar:

Elena Xhina – deputete nismëtare e projektligjit

Ermira Gjeci – Zëvendësministre e Bujqësisë

Kujtim Luli – përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme

Ornela Xhembulla – përfaqësuese e Prokurorisë së Përgjithshme

Artan Syziu – përgjegjës i Sektorit të Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në
Ministrinë e Drejtësisë

Esmeralda Velaj – specialiste e Sektorit të Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në
Ministrinë e Drejtësisë

Luan Leka - përfaqësues i shoqatës “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë”

Dorina Mema - avokate

Alban Zusi – Drejtor ekzekutiv i shoqatës “Albanian Food Industry AFI”

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, datë 28.05.2019, ora 11.00.

Në seancën e sotme kemi për shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, që vjen si një nismë deputetësh.

Relator për këtë projektligj është zoti Besnik Baraj.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi të ftuar: zotin Artan Syziu, përgjegjës i Sektorit të Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore, dhe zonjën Esmeralda Velaj.

Nga Prokuroria e Përgjithshme: zoti Kujtim Luli dhe zonja Ornela Xhembulla.

Më pas do të vijojmë edhe me një seancë dëgjimore me grupet e interesit, pas kërkesës së shprehur nga vetë ata. Bëhet fjalë për “Albanian Food Industry”, shoqata e Industrialistëve Shqiptarë, që do të përfaqësohet nga zoti Alban Zusi, zoti Luan Leka nga shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë” dhe zonja Dorina Mema.

Dëgjesa do të jetë në pjesën e dytë.

Në pjesën e parë, relatori, zoti Baraj do të bëjë një relativitet të shkurtër të ndryshimeve që propozohen në Kodin Penal. Më pas do të vijojmë me pyetje për përfaqësuesit e ministrisë dhe përfaqësuesit e tjerë dhe diskutime nga anëtarët e komisionit.

Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Meqenëse këtu sot ka një përbërje shumë komplekse me të ftuarit, do t’u jap më shumë kohë të ftuarve dhe të gjithë atyre që kanë pyetje për të bërë lidhur me këtë problematikë.

Megjithatë, në mënyrë të përmblendhur do të thosha se ndryshimet e propozuara në Kodin Penal janë hartuar në përgjigje të problematikave që ka ndeshur shoqëria shqiptare kohët e fundit dhe përfshijnë ndryshime në disa fusha sensitive për opinionin shoqëror në përgjithësi, që kanë të bëjnë me rendin, qetësinë publike, me ndalimin e zhurmave, me problematikën mjedisore, me shëndetësinë, me sigurinë ushqimore, që herë pas here i kemi pasur objekte diskutimi, por, mbi të gjitha, kanë qenë shqetësime edhe për opinionin publik.

Në këta 30 vjet kemi vënë re që dëmet që kanë kryer subjekte të ndryshme, apo individë ndaj mjedisit kanë qenë shumë të rënda dhe të dukshme. Duket që Kodi aktual jo vetëm që nuk

është zbatuar, por njëkohësisht ka pasur edhe mungesa në lidhje me krime apo kategorizime të ndryshme ndaj mjedisit.

Më duket me shumë interes fakti që janë bërë objekt i këtij ligji në ndryshimet që do të pasqyrohen, që janë të lidhura edhe me adoptimin e plotë të direktivës europiane në lidhje me mjedisin. Problemet që preken këtu kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit dhe të tokës, me shkaktimin e fatkeqësive mjedisore, me keqmenaxhimin e mbetjeve dhe transportimin e tyre në kundërshtim me ligjin, me zhvillimin e aktiviteteve të rrezikshme dhe veprimtaritë në kundërshtim me ligjin në lidhje me materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme, të cialt sigurisht e plotësojnë këtë projektligj. Shpresoj që ajo që është pjesa më e rëndësishme, zbatimi i të gjitha këtyre që parashikohen në këtë kuadër ligjor, të ndihmojnë në frenimin e dëmeve të mëdha që bëhen në këtë fushë.

Sidoqoftë, kur të vijë momenti për të diskutuar projektligjin, në nenin 203 është bërë një ndryshim në formulimin e ndryshimeve (po e përmend thjesht për informacion), ku bëhet fjalë për ndotjen e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit, grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik. Neni që suprimohet kishte të bënte kryesisht me lëndët materiale ozonholluese, që kanë të bëjnë me faktorët që lidhen me hollimin e ozonit. Kjo nuk pasqyrohet gjëkund në ligjin e ri. Në ligjin e mëparshëm ishte i pasqyruar dhe për mua është një problematikë shumë e rëndësishme që e ndeshim në realitetin shqiptar. Pa dyshim, kjo duhet të pasqyrohet diku, të lihet po aty, ose neni që është futur të kalohet më tej në një vend tjetër.

Nga ana tjetër, ajo që ndeshim rëndom dhe e shikojmë edhe vizualisht, ka të bëjë me ndotjen që vjen si rezultat i qëndrimeve që mbajnë individë të ndryshëm në rrugë dhe ambiente publike apo kur udhëtojnë me makina, që hedhin plastika apo plehra dhe si rezultat shikojmë mbetje, të cilat si nga pikëpamja estetike, por edhe e problematikës tjetër që lidhet me mjedisin dhe shëndetin,.... Mendoj që edhe me ndihmën e kolegëve të stafit të pasqyrojmë një penalitet edhe në lidhje me këtë, e cila të bëhet pjesë e këtij ligji. Pastaj, për realizimin dhe ndjekjen e saj, mund të futet edhe Policia Rrugore.

Sidoqoftë, tek bisedoja edhe me një prej përfaqësuesve të ftuar dhe shumë të respektuar, zotin Luan Leka, një pjesë e aktorëve që kanë veprimtari, që mund të preken nga ky ligj, kanë mendimet e tyre, rezervat e tyre dhe propozimet e tyre të cilat janë të mirëpritura dhe jam i bindur që do të çojnë në përmirësimin e të gjithë këtij formati që sot kemi në duar.

Do të doja ta marrin fjalën aktorët e ndryshëm të ftuar, që do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së këtij projektligji.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Pas fjalës së relatorit, ka pyetje nga anëtarët?

Zonja Xhina, si përfaqësuese e grupit të deputetëve propozues, do t'u përgjigjet pyetjeve.

Halit Valteri - Së pari, bëni shumë mirë që sillni projektligje të tilla ku siguria ushqimore vjen e para. Unë këtu dua të ndalem te pjesa e hartimit të këtij projektligji, ku thuhet: “Prodhimi, shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin, importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja dhe vendosja në qarkullim me ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, lëndëve të tjera ushqimore, barnave të rrezikshme, si dhe futja në prodhim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin dhe përpunimin e artikujve ushqimorë dhe të pijeve në shkelje me kërkesat e legjislacionit të posaçëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet”. Cili është institucioni që e bën këtë matje? Në dijeninë time, është AKU-ja, sepse ky është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, i cili i është drejtuar Kuvendit me një kërkesë ku ka edhe mungesë infrastrukture. A ka laboratorë të posaçëm, dua të pyes zotin Peleshi, pasi ka qenë edhe ministër i Mjedisit dhe a është përgjegjëse AKU-ja për të gjithë këtë? A mundet t'i matim?

Në dijeninë time, AKU-ja është pa drejtues rajonalë, sot që flasim ajo ka 8 të komanduar. A janë punëtorë partish këta, apo janë njerëz të përgjegjshëm, që do të bëjnë matjen?

Së dyti, pjesa më e madhe e problematikave ose konsumi ynë më i madh është mielli. Kush i mat këta parametra furrat e bukës, sepse mielli që hyn në Shqipëri është nën normat e proteinave, që do të thotë se niveli i proteinës për miellin e bukës duhet të jetë 12.5 % dhe për ëmbëlsirat 8 %. Më parë, dy importuesit më të mëdhenj janë çuar për ndjekje penale, pasi kishin futur 100 tonë me 12.5% dhe 200 ose 300 tonë për ëmbëlsira. A i mat njeri këto në furrat e bukës, se po na vrisni çdo ditë? Kush është përgjegjës për këtë?

Pastaj, lidhur me sigurinë e kafshëve, patjetër që duhet të kujdesemi dhe për to, por mendoj se është më e rëndësishme të merremi një herë me sigurinë e njerëzve, se po vdesin përditë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Do të doja t'ju kujtoja që sot nuk kemi diskutimin dhe votimin nën për nen, madje nuk do ta votojmë as në parim. Sot do të bëjmë vetëm diskutimin dhe në seancën

tjetër do të bëjmë votimin në parim, nen për nen dhe pastaj në tërësi. Sot nuk do të hyjmë në shqyrtim të hollësishëm nen për nen, kështu do t'ju lutesha që edhe pyetjet të bëhen duke mbajtur parasysh këtë kuadër.

Fakti që një grup deputetësh ka ndërmarrë këtë iniciativë do të thotë se ka problematika të sigurisë ushqimore që, veç të tjerash, duhet të adresohen me forcim të sanksioneve ligjore. Pa dyshim, nuk janë deputetët ata që duhet të japin llogari për punët ekzekutive. Unë edhe mund ta bëj si ish-ministër, por nuk është ky rasti.

Zoti Bitri, fjala për ju.

Robert Bitri – Qëllimi i kësaj iniciative, që kanë marrë deputetët për të sjellë këtë projektligj sot është që të dimë çfarë duhet të arrijmë dhe çfarë duhet të përmirësojmë. Në qoftë se do të kuptojmë qëllimin, pastaj do të futemi në diskutimin nen për nen.

Nuk është çështja të japin llogari ata që i zbatojnë apo pse i zbatojnë, por si duhet ta përmirësojmë pjesën ligjore që në momentin e caktuar ata që kanë për detyrë për ta zbatuar këtë ligj, ta zbatojnë me përpikëri dhe ne të mos lemë asnjë lloj shtegu për abuzime.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka ndonjë pyetje tjetër në parim?

Ju lutem, prezantohuni, meqenëse kemi edhe anëtarë të rinj dhe na bëni një prezantim të shkurtër të këtyre ndryshimeve të Kodit Penal, duke iu referuar orientimit nga pyetjet e anëtarëve të komisionit.

Elena Xhina - Faleminderit, zoti kryetar!

Jam Elena Xhina, deputete. Bëj pjesë në Komisionin e Ligjeve. Aktualisht, jam relatore e këtij projektligji. Kam arritur të kem njohuri të thelluara në lidhje me të për faktin se jam duke punuar e tërhequr mendime edhe nga aktorët e interesuar lidhur me ndryshimet e projektligjit.

Nëse do ta nisim me pyetjen e zotërisë, së pari, do të doja ta falënderoja për pyetjen, pasi janë pikërisht pyetjet e ngritura ato që tregojnë pse ishte kjo nevojë e menjëhershme e ardhjes së këtij projektligji në Kuvend. Siguria ushqimore dhe mjedisore është fakt që po na vret çdo ditë nga pak dhe janë veprat më të përhapura aktualisht sot.

Pikërisht këtë synon të bëjë ky projektligj, të garantojë rendin dhe sigurinë publike duke plotësuar vakumet ligjore që Kodi Penal në fuqi nuk i parashikon.

Lidhur me pyetjet për AKU-në e të tjerë, nuk do të dija t'u përgjigjesha atyre pyetjeve, pasi kam ardhur këtu për të bërë një prezantim të nismës ligjore dhe për të treguar mënyrën dhe

formulën që përdor Kodi Penal për të mbrojtur shtetasit nga këto vepra penale që ne kemi parashikuar dhe që janë figura të reja në këtë Kod, që përfshijnë sigurinë ushqimore dhe atë mjedisore.

Lidhur me nenin 288 që referuam këtu, pikërisht kjo dispozitë e re synon të bëjë mbrojtjen e shtetasve nga problematikat që kanë lindur në sferën e sigurisë ushqimore dhe asaj mjedisore.

Lidhur me projektligjin, do të thosha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë dispozitat e Kodit Penal. Është fakt që ky Kod, është një nga kodet që ka ndryshuar më së shumti në sferën e të gjitha kodeve dhe ky ndryshim i projektligjit do të shikohet me një farë rezerve, në kuptimin që pse duhet të vazhdojmë të bëjmë ndryshime në Kodin Penal, kur, në fakt, e dimë se Ministria e Drejtësisë është duke punuar për një Kod të ri Penal. Pikërisht emergjenca e këtyre problematikave të ngritura bëri që grupi i deputetëve ta marrë këtë nismë e ta sjellë në komision, nëpër komisionet për dhënie mendimi dhe në atë përgjegjës, për ta kaluar më pas në Kuvend.

Këto ndryshime të Kodit Penal synojnë të bëjnë përmirësime pikërisht në fushat e mbrojtjes së dhunës nga profesionistët shëndetësorë, fakte që ne i kemi dëgjuar kohët e fundit më së shumti se si mjekët janë dhunuar nga familjarë, se si ata janë gjendur të pambrojtur. Pikërisht ky projektligj synon që t'i mbushë këto vakume dhe boshllëqe, synon mbrojtjen nga dhuna të punonjësit të policisë, të funksionarit publik, të zgjedhurit dhe personelit të shërbimit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, ku është parashikuar ndalimi i zhurmave, mbrojtja nga dhuna në sport, një problematikë e përhapur kohët e fundit, mbrojtja e së drejtës së autorit, ndalimi i veprimtarisë së lojërave të fatit, dekriminalizimi i gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut, përdorimi i armëve dhe lëndëve plasëse pa lejen e organeve shtetërore, mbrojtja nga kafshët shoqëruese në publik mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë ushqimore.

Pra, siç ju thashë të gjitha këto vepra penale që futen në Kodin Penal kanë qëllim që të dënojnë çdo veprim dhune ose të parandalojnë dhunën në shoqëri. Futja e këtyre vepra të reja në Kodin penal do të bëjë që shtetasit që kanë kryer këto vepra penale të mendohen dy herë para se t'i kryejnë sërish këto veprime, që tashmë do të përbëjnë vepra penale.

Në projektligj propozohet një ashpërsimi dënimeve për mbajtjen e armëve shpërthyesë ose plasëse.

Gjithashtu, dua të them se sa u përket krimeve mjedisore një nga qëllimet e ndryshimeve në projektligj është *transpozimi* i disa direktivave europiane në fushën e mjedisit. Pikërisht ato janë parashikuar në nenet 201-203 të kreut IV “Për veprat penale kundër mjedisit”, si edhe të shtohen në këtë kre edhe 5 dispozita të reja për veprat penale të kryera nga personat fizikë ose juridikë, të cilat janë veprime që bien ndesh me ligje specifike për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese dhe që rrezikojnë të shkaktojnë dëme reale mbi cilësinë ajrit, tokës, ujit, shëndetit dhe jetës së njeriut.

Siç ju thashë, projektligji adreson problematika që lidhen me sigurinë mjedisore, që është një nga çështjet më sensitive dhe aktuale të ditëve të sotme, ku propozohet të rishikohen dispozitat që janë ekzistuese në Kodin Penal duke kriminalizuar fenomene ose sjellje, të cilat janë në kundërvajtje me ligjet specifike. Këto propozime kanë për qëllim të mbrojnë sferat më specifike të jetës së njeriut dhe ato që hasen në veprimtarinë e përditshme të njeriut.

Para se grupi i deputetëve ta sillte këtë projektligj në Kuvend, është konsultuar me aktorët e interesuar, siç janë Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, OSBE-ja, Misioni Euralius, Komiteti i Helsinkit, Fakulteti i Drejtësisë, ministritë e linjës dhe Këshilli i Ministrave.

Megjithatë, unë e pranoj që projekti ka nevojë për ndryshime, por që të bëhen përmirësimet e duhura duhet që ai të kalojë fillimisht në parim dhe pastaj nën për nen. Ne jemi të hapur që të marrim mendimet e të gjithë deputetëve lidhur me fushat përkatëse që ata mund të kontribuojnë për të bërë përmirësimet e duhura në projektligj.

Unë propozoj që ta miratojmë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka pyetje, apo diskutim nga deputetët?

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Ju përgëzoj për nismën që keni ndërmarrë! Ju falënderoj, kolege, për shpjegimet që dhatë!

Unë do të doja të bëja një diskutim të shkurtër në mbështetje të kësaj iniciative, që vjen si domosdoshmëri. Ligjet shkruhen në kohën e caktuar dhe në varësi të problematikave, të cilat dalin. Unë besoj që kjo iniciativë ka ardhur pikërisht sepse në fusha të ndryshme kemi disa lloje krimesh, të cilat në Kodin aktual Penal nuk gjejnë mbështetjen e nevojshme. Do të doja të theksoja se këto ndryshime jemi duke bërë, sepse kemi situata që mund të quhen alarmante.

Sigurisht kemi problematika të caktuara edhe në sigurinë ushqimore, por kemi një grup të tërë njerëzish, të cilët punojnë dhe lodhen ditë për ditë për të prodhuar, për të punuar për të siguruar për të gjithë. Sigurisht brenda tyre ka edhe elementë të caktuar që edhe mund të kryejnë krime për të cilat ne jemi duke bërë këto ndryshime.

Të gjithë duhet të jemi koshientë që shoqëria avancon, problematikat që lindin janë nga më të ndryshmet, ndërsa ne jemi pikërisht këtu që të bëjmë të mundur që me ndryshimet ligjore t'iu përafrohemi sa më shumë problematikave që lindin dhe që krimet të minimizohen.

Ne jemi duke bërë disa ndryshime për dhunën në stadiume. Nuk mund të themi se është një fenomen shumë i përhapur, por meriton të adresohet, sepse është mirë që shfaqjet sportive, që në thelb janë shfaqje argëtuese për shoqërinë, të mos kthehen në shfaqje të dhunshme, aq më tepër për njerëz që bëjnë punën e tyre.

Kur të vijë diskutimi nen për nen do të bëjmë ndërhyrje në atë pjesë të ndryshimeve të Kodit Penal, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e komisionit tonë, por unë personalisht shpreh mbështetjen time për ndryshimet e propozuara.

Nimet Musaj – Faleminderit!

Unë mbështes gjithçka që ju pasqyruat këtu. Si ish - sportist vlerësoj nismën të shmangim gjithçka të dhunshme që nuk i përket sportit dhe futbollit. Do të mbështes çdo ligj dhe projektligj që i vjen në ndihmë jo vetëm zhvillimit të futbollit në Shqipëri, por edhe kulturës dhe asaj që duhet të bëjmë në stadiume.

Halit Valteri- Zoti Pëllumbi, unë e kam në parim, sepse problemi është si do ta luftojmë rastin. Pra, do të kapim të gjithë furrxhinjtë, apo do të shkojmë direkt te burimi, tek ai që e sjell miellin? Është shumë e thjeshtë ta vendosim në ligj që niveli i proteinës duhet të jetë 12,5%, dhe nuk ka probleme pastaj as doganieri, as ministri, as drejtori i Përgjithshëm i Doganave, as i Tatimeve as deputetët që ndërhyjnë. E bëjmë këtë të gjithë bashkë dhe nuk ka asnjë lloj problemi. Të gjithë kemi mendimin të kemi bukë të mirë në Shqipëri.

Zef Shtjefni - Në fakt, e lexova projektligjin. Unë jam avokat dhe jam marrë me këtë pjesë, por unë mendoj se është i vonuar. Këtu janë disa çështje që shtrohen, jo vetëm në një fushë. Duhet të shihet më gjerë ky problem.

Siguria ushqimore, mjedisi, mbrojtja e zyrtarit publik, mbrojtja e kafshëve, dhuna në stadiume janë shumë të rëndësishme. Siguria ushqimore sot është skandal. Po të shkoni sot në treg, një luleshtrydhe është sa një grusht, kjo është absurde. Pra, ndërhyrja duhet me çdo kusht.

Sa i përket fushës së mjedisit, janë disa zona që duhet të ruhen.

Gjithashtu, mbrojtja e zyrtarit publik është shumë e rëndësishme.

Besnik Baraj – Unë bashkohem me kolegun që tha se ndryshimet janë shumë komplekse dhe përfshijnë shumë fusha. Do të ishte mirë që në lidhje me të drejtën e autorit, duhet ta fragmentarizojmë diskutimin për tema të veçanta, të thërrasim dhe përfaqësues nga komuniteti lidhur me problematikat e zhurmave, për shembull që i ndeshim çdo ditë në lagje, madje ka raste që lajmërohen edhe subjektet që merren me këtë punë, po shpeshherë ato janë anemike dhe bëjnë kompromise. Pra, të gjitha problemet duhet t'i adresojmë dhe të nxjerrim nga duart tona një projekt sa më të mirë. Do të ishte mirë që, sikurse e tha edhe kolegu, të bënim edhe dëgjesa me grupet e interesit.

Siguria ushqimore është pjesa më sensitive që ka publiku. Nganjëherë abuzohet në medie, për shembull, lidhur me përmbajtjen e proteinave në grurë nuk na vret nëse janë 8 ose 12%, problemi është që konsumatori nuk merr sasinë dhe cilësinë e duhur, por jo se të vret. Te mielli mund të ketë probleme të tjera, për shembull përmbajtja e mykotoksinave, a realizohet analiza në Shqipëri e të tjera. Pra, ka një sërë elementesh. Ne duhet të zhvillojmë kapacitetet tona laboratorike, instrumentale në mënyrë që t'i ofrojmë qytetarit atë ushqim me cilësinë e duhur. Unë në një kohë kam mbuluar këtë sektor dhe kam një informacion shumë më të plotë dhe që mund t'u jap edhe përgjigje kolegëve në lidhje me laboratorët.

Halil Jakimi – Faleminderit!

Në këtë projektligj kam vërejtur disa probleme, që kanë të bëjnë me mjedisin. Dihet që moratoriumi i pyjeve dhe i gjuetisë është ende në fuqi. Gjithashtu, unë them se ne i kemi ligjet e duhura mjedisore. Megjithatë, kemi gjueti të palejuar, prerje dhe shfrytëzim masiv të pyjeve, veprimtari që është evidentuar edhe në emisione të ndryshme investigative, të fortët rrëmbejnë armët dhe dalin e gjuajnë në pyll, dëmtojnë habitatet, dëmtojnë zonat e mbrojtura e të tjera. Por shoh edhe mungesë nga ana e organeve ligjzbatuese, të cilat duhet të marrin masat e duhura dhe t'i dënojnë personat që ushtrojnë aktivitet të paligjshëm.

Në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, desha një sqarim. Ata që nuk menaxhojnë mbetjet dënohen me gjobë ose dy vjet burg? Në fakt, dëmet mjedisore në mjedis janë të një spektri shumë të gjerë, por janë relative, sepse nuk ka një matës përkatës dhe nuk mund të thuash që shkaktove këtë dëm dhe do të dënohesh kaq. Vetë qeveritë janë të papërgatitura me

financimin me buxhet të njësive vendore për t'u ofruar infrastrukturën që të ndërtojnë landfillle ose vende të përshtatshme për vendgrumbullimin e mbetjeve.

Këto pika i shoh të diskutueshme në momentin kur të na vijë mundësia që të shprehemi nen për nen. Unë jam i fushës dhe mendoj se këto pika duhet të shqyrtohen.

Dritan Bici - Në fakt, unë e mbështes nismën e deputetëve për ashpërsimin e Kodit Penal për problemet që u paraqitën këtu. Ky reagim ka ardhur si rezultat i problemeve që janë hasur kohët e fundit sa i përket dhunës ndaj mjekëve, dhunës në futboll, problemet me sigurinë ushqimore.

Në këtë komision ne jemi marrë edhe më parë me AKU-në, madje kemi organizuar edhe vizita tek AKU-ja. Është ushtruar trysnia e ligjvënësve ndaj këtij enti publik.

Pra është ushtruar trysni, nuk është se problemet dolën tani, pasi këto gjëra janë parë edhe më parë. Dua t'ju them se ka shumë nevojë për ndryshime në këto struktura, për shembull tek AKU-ja. Nuk ka pse të merret AKU-ja me kontrollin e këtyre produkteve ushqimore që hyjnë në doganë, që vijnë nga jashtë, sepse po ta shohësh Italinë, këtë detyrë e kryen dogana dhe nuk ka pse të merret AKU-ja me këtë punë. Dogana, duke pasur specialistët e saj, e bën aty kontrollin, sepse AKU-ja merret vetëm me terrenin. AKU-ja mund të ketë laboratorë nëpër rrethe, por këto laboratorë në radhë të parë duhet të jenë nëpër dogana për të bërë kontrollin e hyrjes, i cili në fillim duhet bërë aty, sepse janë shumë produkte, të cilat je i detyruar për t'i futur, pasi ato mund të prishen. Më pas bëhen analizat e të tjera me radhë, por ndërkohë produkti ka hyrë dhe allishveriset janë bërë.

Pra, nëse u thuhet “ndal” që në doganë, këto gjëra nuk do të ndodhin. Me aq sa di unë në Itali me këto gjëra merren laboratorët që janë nëpër dogana.

Gjithashtu, dua t'ju them se këtu ka një gamë të gjerë problemesh, duke filluar me neglizhencën e mjekut, me sportin, me mjedisin, AKU-ja e kështu me radhë. Ne nuk mundemi që me kaq pak kohë që kemi në dispozicion t'i ezaurojmë të gjitha këto probleme, prandaj dua t'ju them që për të gjitha këto probleme është e nevojshme të bëhet një konsultë më e gjerë me grupet e interesit.

E para, me mjekun, sepse aty thuhet neglizhenca, për këtë punë nga kaq deri në aq, por për mua kjo gjë është e rëndë, prandaj duhet ashpërsuar ligji për të mbrojtur mjekët, në mënyrë që të mos goditen. Unë nuk e kuptoj se çfarë doni të thoni me fjalën “neglizhencë”. Askush prej mjekëve nuk besoj të neglizhojë me ndërgjegje, pasi askush prej tyre nuk dëshiron që asnjë prej

të sëmureve t'u ngelet në dorë, sepse të gjithë ata kur e kanë filluar këtë profesion kanë bërë një betim “Betimin e Hipokratit”.

Ne nuk jemi në fazën për t'i kërcënuar mjekët, por duhet t'i përkrahim ata dhe duhet të krijojmë...

Elena, ti je e pjesës ndëshkuese, je avokate, unë jam...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj se nëse do të bëjmë ndonjë ndryshim, ai duhet bërë për t'i mbrojtur mjekët. Ndodh diçka, vdiq dikush, të gjithë turren për të arrestuar mjekun, por mjeku nuk është kriminel për ta trajtuar si ata kriminelët e rëndomtë, mjeku është një intelektual që ka bërë betimin në vetvete dhe ka kryer shkollën për t'u ardhur në ndihmë njerëzve dhe nuk besoj se me gjithë atë shkollë që ka bërë, të ketë mjek të neglizhojë me ndërgjegje. Në këtë drejtim dua që të jemi pak më tolerantë, prandaj mendoj se duhet të bëjmë një konsultim me mjekët.

Sa i takon AKU-së, duhet të konsultohemi edhe me grupet e interesit, sepse nuk mendoj të jetë shkak mungesa ligjore ajo që na çon drejt problemeve të ndryshme, siç mund të jenë ato për mjedisin, për sigurinë ushqimore e shumë gjëra të tjera. Ne duhet të ushtrojmë më shumë presion ndaj institucioneve, sidomos ndaj zbatimit të ligjit, megjithatë ndryshimet janë të nevojshme dhe unë i mbështes ato.

I falënderoj të gjithë ata që janë marrë me këtë punë!

Niko Peleshi – Para se ta marrë fjalën zoti Sinaj, zoti Baraj ka diçka procedurale.

Besnik Baraj – Sa u takon propozimeve që ne bëjmë për të pasur sa më shumë dëgjesa me grupet e interesit, do të propozoja që të kemi dëgjesa vetëm me ato grupe interesi, tematikat e të cilave i mbulon komisioni ynë dhe në këtë mënyrë do të bëhemi më racional dhe më pas komisionet e tjera do të mbulojnë tematikat përkatëse që kanë në veprimtarinë e tyre.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Pëllumbi, për procedurë.

Arben Pëllumbi – Duke marr shkas nga ajo që tha kolegu, dua t'ju them se për këtë projektligj diskutimet në Kuvend kanë filluar gati një vit e gjysmë më parë, çka do të thotë se kjo gjë nuk po bëhet me nxitim, por është diçka që është konsultuar. Në dijeninë time është konsultuar edhe me Euraliusin, me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me OPDAT-in.

Pra, të gjitha ndryshimet që na kanë ardhur janë ndryshime të kolauduara për këtë Kod Penal që po ndryshojmë. Nga krahu tjetër janë edhe komisionet e tjera të Kuvendit, të cilat në

varësi të fushës së tyre po bëjnë diskutimet përkatëse për bllokun e neneve që do të ndryshojnë, të cilat i përkasin asaj fushe.

Sigurisht, ju mund të keni shumë të drejtë për mjekun, por nuk jemi ne ata që jemi specialistë të kësaj fushe, por është Komisioni i Shëndetësisë ai që po merret dhe po i trajton këto tema, sikurse diku tjetër janë komisionet si Komisioni i Ligeve, Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe komisionet e tjera.

Ne do të përqendrohemi, siç e tha me të drejtë zoti Baraj, në fushën tonë të veprimtarisë, për të cilën më pas do të diskutojmë edhe me aktorët e interesit, kështu që mendoj të vazhdojmë më tej, pasi jemi në kohë për t'i aprovuar siç duhet këto ndryshime.

Niko Peleshi – Zoti Sinaj, e ka fjalën.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se është e domosdoshme të dëgjojmë më shumë palët e interesit. Ne nuk mund të bëjmë ligje që nuk i shërbejnë shoqërisë, biznesit apo mjekëve. Pra, nuk mund të bëjmë një ligj pa dëgjuar mjekun dhe ndonjë pacient, sepse në këtë mënyrë i japim më shumë rëndësi. Gjithashtu, duhet të mendohemi mirë kur gjykojmë këtë apo atë projektligj në çdo aspekt të tij, sepse kjo ka të bëjë drejtpërsëdrejti me marrëdhëniet e mjekëve, për të cilat ky vend ka shumë nevojë. Duke u ndodhur në një situatë të tillë, faktikisht e vërteta është se ne kemi nevojë për mjekë, ndërsa ata largohen nga Shqipëria. Atëherë duhet patjetër ta dëgjojmë fjalën e tyre.

Unë do të ndalem te pjesa e biznesit, të cilën e përfaqësoj edhe vetë. Gjëja e parë që ne duhet ta diskutojmë më gjatë dhe ta vlerësojmë më mirë është: a përshtatet ky projektligj me ligjet e Komunitetit Europian për tregun ushqimor?

Pra, në këtë mënyrë ne nuk duhet të mblidhemi prapë pas këtij projektligji për të bërë një projektligj tjetër për ta përafruar këtë projektligj me ligjin e Komunitetit Europian apo të vendeve të Europës. Unë e kam parë këtë projektligj dhe në nenin 288, shkronja “c”, ka shumë probleme, të cilat duhen diskutuar, jo vetëm për ta përafruar me Europën. Si pikë të dytë dua t’ju them se ky ligj nuk duhet të bëhet në mënyrë të shpejtë pa dëgjuar mirë palët e treta, të interesit, sepse biznesi është ai që paguan përditë taksa, është ai që mbush buxhetin e shtetit, është ai që na jep mundësi për ta mbajtur shtetin në këmbë nga importi në dogana dhe në vazhdim.

I gjithë projektligji duhet parë me shumë kujdes, sidomos neni 288, germa “c”, sepse ka shumë probleme qoftë me mënyrën se si janë paraqitur produktet, por ka edhe shumë gjëra të tjera që duhen diskutuar.

A është gabimi njerëzor vepër penale? E them këtë gjë përsëri sot, sepse nuk mund të fshihemi prapa gishtit për të thënë që nuk ka largim nga Shqipëria. Po marr një shembull. Një punonjës duhet të shkojë për të punuar në një biznes dhe punëdhënësi para se ta marrë në punë i thotë: “Shiko, ti do të vish dhe do bësh këtë proces pune, por po bërë këtë gabim ligji të dënon me 3 vjet burg?” A do të shkojë ky punonjës të punojë atje? Pra, për të gjitha këto arsye mendoj se palët e interesit duhet të dëgjohen mirë.

Pak a shumë këto ishin ato që kisha, pasi ne do ta diskutojmë projektligjin nen për nen. Unë mendoj se duhet të jemi të vëmendshëm, sepse ligjet nuk i bëjmë vetëm ne. Ne i bëjmë ligjet që ato të jenë në shërbim të biznesit, në shërbim të qytetarëve, të dënojmë atë që duhet të dënohet dhe jo të digjet i njomi bashkë me të thatin. Ligji duhet të dënojë atë që e bën me qëllim prodhimin e një produkti të skaduar apo të një produkti që përmban brenda parametrat që duhen.

Pra, duke bërë një ligj, i cili brenda vetes së tij mund të ketë mënyra të ndryshme për t’u interpretuar, i krijohen probleme biznesit të ndershëm.

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese është një komision që e ka dëgjuar gjithmonë biznesin dhe palët e treta, prandaj besoj se edhe këtë radhë të gjithë deputetët do të jenë të vëmendshëm ndaj miratimit të ndonjë neni që mund të prekë interesat e biznesit, gjithmonë duke ruajtur shëndetin e popullatës, por me qëllimin e vetëm për të shkuar tek ai që e ka vërtetë fajin dhe jo t’i biem në qafë dikujt tjetër që mund të ketë bërë një gabim njerëzor.

Unë mund t’ju them të shkoni dhe të bëni vizita nëpër botë, të blini nëpër dyqanet ushqimore dhe ju garantoj se edhe atje ka gabime njerëzore, sepse mund të qëlloj të ketë ndonjë produkt në skandencë, por data është e shkruar dhe gjithkush mund ta shohë. Nëse një punëtor supermarketi e ka për detyrë për ta kontrolluar dhe e ka harruar kjo quhet gabim njerëzor dhe nuk mund të jetë vepër penale.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Sinaj!

Ne sapo kemi filluar diskutimet e këtij projektligj dhe, siç e thamë, më pas do të ketë një dëgjese me grupet e interesit, janë dy shoqata prodhuesish me shumë eksperiencë dhe më pas do të vazhdojmë me diskutime të tjera të hollësishme gjatë diskutimit nen për nen. Unë mendoj se propozimet e zotit Baraj, të zotit Shtjefni dhe të zotit Sinaj, për të menduar edhe dëgjesa të tjera me grupet e interesit brenda fushave tona janë të vlefshme. Natyrisht, ne të gjithë jemi parlamentarë dhe ligjëbërës, prandaj kemi të drejtë të japim mendimet tona për çdo lloj ligji këtu

dhe në seancë plenare, por për t'i kushtuar sa më shumë energji këtij komisioni dhe fushave që nuk janë tonat besoj se është e tepërt (e kam fjalën që nuk mund të bëjmë tani dëgjesa me grupet e interesit, si mjekë, sportistë e të tjerë, pasi nuk janë drejtpërsëdrejti misioni dhe fusha e komisionit).

Gjatë diskutimit nën për nën mund të japim mendimet dhe propozimet tona për komisionet e tjera. Mjedisi, siguria ushqimore, të cilat na preokupojnë më tepër për shkak të misionit tonë do t'i diskutojmë më hollësisht. Ndaj të njëjtin mendim dhe shqetësim me pjesën më të madhe të anëtarëve të komisionit, të cilët u shprehën se nuk mund të sigurohet gjithçka me anë të një ligji. Për mendimin tim personal, ne e kemi edhe pak kulturore që i lëmë gjërat dhe më pas mundohemi t'i zgjidhim me një të rënë të sopatës, të zgjidhje të tilla nuk ka. Zgjidhjet duhet të jenë sistematike dhe integrale. Ne do të mundohemi të nxjerrim nga duart tona ndryshimet e mundshme më të mira të Kodit Penal dhe të synojmë që ato të jenë të përjetuara me standardet e legjislacionit europian, por edhe sikur të bëjmë ndonjë mrekulli këtu është e pamundur që ky kod i ri i rishikuar të garantojë siguri ushqimore, siguri mjedisore, eliminim të dhunës në disa fusha e të tjera.

Zgjidhjet vijnë vetëm në mënyrë të integruar, duke i reformuar sistemet, duke i riinxhinierizuar proceset, duke i modernizuar ato, duke rritur kapacitetet njerëzore logjistike, si dhe duke forcuar sanksionet ligjore. Suksesi nuk mund të arrihet edhe sikur një nga këto hallka të cedojë.

Sa i përket sigurisë ushqimore, meqenëse zoti Valteri dhe zoti Baraj më ftuan të jap edhe unë mendimin tim, për shkak të eksperiencës, është një moment shumë i mirë për të bërë një hap të rëndësishëm përpara drejt një standardi të ri të sigurisë ushqimore. Kjo për disa arsye:

Së pari, sensibiliteti publik është rritur. Këtu dua të falënderoj edhe mediet, pavarësisht, siç e tha edhe zoti Baraj, ndonjëherë e kanë tepruar, kanë spekuluar dhe e kanë ekzagjeruar, duke dhënë alarm fals, si dhe kanë shkaktuar edhe ndonjë lloj paniku, por në fund të fundit, duke e parë pozitivisht kjo ka sjellë një ndërgjegjësim më të lartë të konsumatorit shqiptar dhe të të gjitha institucioneve të tjera.

E vërteta është që ne kemi ushqime jo siç mund të perceptohet pas një fushate të fortë përsigurinë ushqimore. Mjafton t'i referohemi faktit që eksportet tona ushqimore janë duke u rritur dhe një pjesë e mirë e tyre shkojnë drejt vendeve të Bashkimit Europian. Ne eksportojmë, për shembull, në fushën e përpunimit të peshkut, e them shpeshherë këtë edhe në mënyrë të

figurshme, por kjo është e vërtetë, i shesim peshk Norvegjisë. Pra, standardet tona janë shumë të larta dhe këta sektorë janë duke u bërë gjithnjë e më tepër konkurrues. Furnitorët tanë të tregtisë me pakicë të ushqimeve janë përgjithësisht perëndimorë. Nuk e di se pse vendi ynë në dallim nga të gjitha vendet e tjera të rajonit e ka shumë më të lartë përqindjen e importeve nga vendet perëndimore. Kjo mund të mos jetë domosdoshmërisht pozitive, sepse ne na duhet ta rrisim shkëmbimin tregtar ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor apo gjithë Ballkanit, por tregu dhe konsumatori janë të prirur drejt produkteve perëndimore.

Pra, qoftë në import apo në eksport, ku reklamimet tona janë shumë të vogla ne mund ta gjejmë referencën e një sigurie ushqimore optimale dhe të pranueshme në vendin tonë. Kjo nuk do të thotë se kemi arritur standardin më të lartë të mundshëm, pasi edhe në vendet e Bashkimit Europian vazhdimisht ka skandale apo incidente të sigurisë ushqimore, sepse ky është një proces që nuk ka fund, por ka vetëm ndjekje dhe përmirësim të vazhdueshëm qoftë legjislativ, qoftë edhe të riinxhinierimit të proceseve.

Kur flas për riinxhinierim të proceseve në vendin tonë, ajo me të cilën institucionet duhet të merren më tepër është gjurmueshmëria. Gjurmueshmëria, është e përcaktuar dhe e fiksuar në ligj, ku çdo kompani ka për detyrim të mbajë rekorde dokumentare të të gjitha proceseve, të lëndëve të para të produkteve që nxjerr, por siç e dimë ne nuk vuajmë nga mungesa e ligjeve, por nga zbatimi i tyre. E para.

E dyta, e kemi të nevojshme që këtë gjurmueshmëri mundësisht ta bëjmë të dallueshme edhe nga konsumatori. Kemi bërë disa përpjekje. Jam i bindur që qeveria po vazhdon të investojë në këtë drejtim, në mënyrë që edhe konsumatori ta dallojë lehtësisht një produkt, në të gjithë gjurmueshmërinë e tij, ku ka lindur, si ka lindur, si është furnizuar me lëndë të parë, ku është prodhuar, tregtuar e të tjera. Këtu na takon, edhe për mision, të ushtrojmë presion edhe ndaj institucioneve, për t'i shtyrë para.

AKU-ja është një institucion, që ka filluar të bëjë një punë shumë të mirë. Të mos ju kthej 2 vjet mbrapa, kur AKU-ja ishte një plaçkë tregu. Ka mbaruar ajo kohë. Ndonjëherë e pranojmë këtë si një gjë të vogël: “Dakord, nuk ka korrupsion, por ka kusure të tjera”. Natyrisht, ka shumë kusure, por është arritur një gjë shumë e madhe, një betejë që nuk e kemi fituar me shumë institucione të tjera. Pra, AKU-ja nuk është më një institucion që prodhon ryshfete në këmbim të mbylljes së syrit për sigurinë ushqimore. Nuk është absolute kjo që po them, por ama hapat e hedhur janë shumë të mëdhenj. Tani na duhet ta pasurojmë më tej.

Është bërë një investim shumë i mirë për laboratorin dhe përgjigja është: “Po, ka laboratorë, zoti Valteri.” Kemi një laborator reference, që është ISUV-i, i cili sot ka 53 teste të akredituara, nga 7 që kishte para 2 vjetësh. Kemi 6 laboratorë rajonalë, që janë nën administrimin e AKU-së. Nga një projekt i Bashkimit Europian, disa miliona euro janë investuar për të shtuar pajisjet atje. Sfida ngelet te kapacitetet njerëzore, pra ekspertët që duhet t’i përdorin këto mjete. Kemi pasur dhe kemi raste kur donatorët, me bujarinë e tyre, na dhurojnë pajisje laboratorësh dhe ato ngelen në kuti për vite të tëra, sepse nuk se ka kush t’i përdorë.

Pra, probleme ka plot, por piketat janë hedhur dhe, ky kontribut, që po japim me këto ndryshime ligjore, është i çmuar, po ta mendojmë të vendosur në radhë me shumë përpjekje të tjera për të arritur sigurinë ushqimore. Nuk mund t’ia dalim dot vetëm me disa ndryshime ligjore, sado t’i forcojmë ato. Madje, një shprehje angleze thotë se gjërat ndonjëherë bëhen më keq nën presion. Duhet të kombinohet presioni me ndryshimet e tjera. Besoj se jemi në rrugën e duhur dhe sensibilizimi i opinionit publik për sigurinë ushqimore vetëm na ndihmon.

Për sa i përket bukës, kam një informacion të shkurtër. Siç e tha edhe zoti Baraj, çështja e proteinës së bukës është çështje cilësie, jo sigurie, në kuptimin e shëndetit. Ama, duhet të kemi parasysh që Shqipëria është ndër vendet e vetme, të paktën në Europë, që e mat cilësinë e bukës pothuajse vetëm në parametrin e proteinës. Po e lëshuam edhe këtë (ju keni shumë të drejtë, zoti Valteri), pra po ceduar edhe te proteina, minimumi i së cilës, sipas legjislacionit tonë, duhet të jetë 12,5%, pastaj çfarë do të na ngelet?

Një arsye pse buka në Shqipëri, krahasuar me shumë vende të tjera, kryesisht perëndimore, është shumë më e lirë, është se ka, si të thuash, shumë pak parametra të detyrueshëm për t’i zbatuar. Ndërkohë, në vendet e tjera, për shembull, në Francë (mund të mos jem shumë korrekt), janë mbi 30 parametra që buka duhet të plotësojë. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që çdo parametër ka koston e vet.

E thashë këtë për ta ritheksuar dhe për t’ju dhënë edhe juve të drejtë. E kemi domosdoshmëri të forcojmë gjurmueshmërinë, presionin dhe kontrollin mbi gjithë prodhuesit dhe tregtarët e miellit, për të mos ceduar te legjislacioni, pra te norma minimumi 12,5% i proteinës që duhet të ketë mielli i përdorur për bukë.

Kemi pasur edhe aksione shumë të forta. Para pak muajsh janë bllokuar në doganë rreth 400 tonë miell pikërisht për shkak të proteinës. Ky miell vinte nga Kosova. Ky është një presion që duhet bërë vazhdimisht.

Ju keni të drejtë, AKU-ja, institucionet e tjera dhe dogana, kanë për detyrë të mos e trajtojnë si aksion, si fushatë, por ta fusin në një procedurë të përhershme kontrollin e çdo kilogrami miell që hyn në vendin tonë.

Ka diskutime ose pyetje të tjera para se të kalojmë në dëgjuesën...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dritan Bici – ...proteina nuk sjell problem te shëndeti i njerëzve.

Niko Peleshi – Nuk e thamë ashtu.

Dritan Bici – Kohët e fundit, është vërtetuar nga studimet se disekuilibri i elementeve ushqimore të miellit sjell probleme në shëndetin mendor.

Niko Peleshi – Thamë të kundërtën. Ne thamë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thamë që ne nuk duhet të cedojmë te proteina e bukës, pra proteina 12,5% e fiksuar me ligj, duhet të zbatohet. Ky është minimumi i mundshëm që duhet të kërkojmë ne, sepse po ceduam edhe te proteina, nuk kemi si ta matim cilësinë e bukës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Valteri.

Halit Valteri - Unë jam dakord me zotin Peleshi, i cili thotë se ne eksportojmë peshq ose perime, por problemi është se ato kanë cilësi, se atje ku i çojmë ne, nuk ta zbrazin kamionin nëse ato nuk janë në parametra, ndërsa këto që vijnë te ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë kemi edhe përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme këtu, kam edhe një dokument. Një subjekt (nuk dua t'ia përmend emrin) në qarkun e Kukësit ka eksportuar mijëra tonë miell. Prokuroria e Përgjithshme e ka marrë raportin në fjalë. Kanë dalë analizat nga AKU-ja ose nga institucionet përkatëse ligjzbatuese dhe asnjë gjë nuk është bërë me të. Ky është një informacion i sapoardhur. Mund ta printojmë dhe t'ua japim gjithë deputetëve ta shikojnë.

Ligji duhet të zbatohet për të gjithë. Ne po bëjmë ndryshime në Kodin Penal, nuk po bëjmë muhabet kafeje. Po ndryshohet Kodi Penal, po ndërhyjmë te Kodi Penal. Hajdeni ta saktësojmë! Ta bëjmë një për të gjithë, ta shtrëngojmë këtë ligj, se po flasim për bukën... Nuk mora këtë që ka bërë ligjin për bllokimin e rrugëve, se mund të futemi edhe aty, por nuk më duket ndonjë gjë kushedi se çfarë. Do të merremi edhe me atë, por mielli është baza, është buka që hamë çdo ditë.

Hajde të bëhemi të gjithë në një mendje, ta punojmë këtë ligj, të ngremë një grup pune dhe ta sanksionojmë me ligj, që të mos guxojë njeri “të bëjë numra” te kjo pjesë!

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Valteri, kur të shkojmë te diskutimi nen për nen, mund të bëni propozimin se si e mendoni ju riformulimin e nenit përkatës.

A ka ndonjë diskutim tjetër?

E mbyllim seancën e parë të diskutimit të projektligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit, për shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.”” (Nismë deputetësh)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Robert Bitri, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi dhe Gjetan Gjetani.

Të ftuar:

Luan Leka – Përfaqësues i Bashkimit Tregtar të Shqipërisë

Dorina Mema – Avokate

Alban Zusi – Drejtor ekzekutiv i Albanian Food Industry (AFI)

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Niko Peleshi – Pika e dytë e rendit të ditës është një seancë dëgjimore me grupet e interesit.

Me kërkesën e tyre, kemi përfaqësues nga Albanian Food Industry, Qendra e Eksporteve Shqiptare dhe Bashkimi Tregtar i Shqipërisë, i përfaqësuar nga zoti Luan Leka. Përfaqësues nga Albanian Food Industry është zoti Alban Zusi. Nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural është e ftuar zonja Gjeçi, zëvendësministre.

Kush e do fjalën?

Fjalën e ka zoti Leka.

Luan Leka – Faleminderit!

Unë vij si përfaqësues i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë dhe Bashkimit Tregtar Shqiptar. Ndaj mendimin e pothuajse të gjithë anëtarëve të këtyre shoqatave.

Ju falënderoj që na dëgjoni!

Kuptohet që përgjegjësia për ligjet është e politikës, por, duke qenë ligje me impakt të fortë ekonomik, është e domosdoshme të themi edhe ne mendimin tonë. Besoj se u bëjmë mirë të gjithëve.

Duhet të them se është i drejtë shqetësimi për sigurinë ushqimore, i shprehur gjerësisht në mbledhje. Ndajmë këtë shqetësim, si dhe politikën e forcimit të masave për shkeljen e sigurisë ushqimore. Megjithatë, mendoj se ka vend për të ndërhyrë, për të saktësuar disa gjëra dhe për ta përmirësuar ligjin.

Çfarë do të rendisja këtu?

Së pari, do të theksoja referimet që duhet të ketë ligji për sigurinë ushqimore në legjislacionin ekzistues shqiptar.

Ne nuk jemi pa legjislacion. Kemi dy ligje bazë: njëri është ligji për ushqimin, rregullorja europiane e përshtatur nr. 178/2002, tjetri është ligji për etiketimin. Ky është një ligj shumë i mirë, i bërë vetëm një vit më parë, konform ligjeve më të mira europiane dhe rregulloreve europiane në këtë fushë.

Do të doja që shkeljet, për të cilat propozohen masat ndëshkuese përkatëse, t'u ishin referuar shkeljeve që parashikohen në këto ligje, për të cilat sot ka masa ndëshkuese, jo të parashikuara në Kodin Penal, por masa administrative.

Pse e them këtë? Nisem nga defektet që kanë propozimet ekzistuese.

Dua të rendis disa nga defektet parimore. Përmenda të parin mosreferimin në ligjet aktuale. Do të përmendja edhe vështirësinë për të përcaktuar personat përgjegjës, që ngarkohen me përgjegjësi ligjore në rastin e shkeljeve të paraqitura.

Për shembull, sot Shqipëria ka rreth 800 supermarkete. Në rast se në raftin e një supermarketi gjendet një produkt jo konform rregullave, kush e ka përgjegjësinë për këtë? Tregtuesi apo prodhuesi? Këto lloj përgjegjësish duhet të dalin qartë.

Ka edhe një gjë tjetër, që do të dija të dilte qartë në ligj, nëse një shkelje e sigurisë ushqimore bëhet në keqbesim apo ndodh si një gabim në punë.

Zoti Sinaj tha më parë një shembull shumë të thjeshtë. Në një supermarket ka mesatarisht 5000-10000 produkte, shumëzuar me kutitë që ka secili bëhen 20 mijë-30 mijë kuti. Të gjitha kanë data skadence. Menaxhimi i datave të skadencës bëhet nga 2-3 persona në sallë, të cilët i kontrollojnë çdo ditë, por për një gabim njerëzor dikujt mund t'i shpëtojë një datë skadence. Ky është një gabim i ndëshkueshëm me masë administrative, me të drejtë. Që të ndëshkohet me një masë penale, është e diskutueshme, po të konfrontohet ky gabim me një shkelje tjetër, e cila bëhet me dashje, keqbesim, falsifikim të datës së skadencës apo të datës së produktit. Këto janë dy gjëra krejt të ndryshme. Ne do të ishim dakord që kjo e dyta të dënohej penalisht, ndërsa e para, që ndodh nga pakujdesia në punë, të ketë një ndëshkim me masë administrative, mbas edhe më të ashpër se ajo që është sot.

Do flas për një element të thjeshtë. Në të gjitha nenet e ligjit përmendet ruajtja e produkteve, pra thuhet “ruajtja e produkteve, të cilat nuk plotësojnë kërkesat për sigurinë ushqimore”.

Do të doja t'u vija në dukje ligjbërësve, që, ruajtje të produkteve, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë ushqimore para asgjësimit, sot ka në të gjitha supermarketet dhe nuk mund të jetë ndryshe. Të gjitha produktet ruhen para asgjësimit. Pra, ka diçka për ta ratifikuar në ligj. Këto produkte ruhen në pritje të institucioneve, të cilat duhet të asistojnë në asgjësim. Janë tri institucione: tatimet, AKU-ja dhe mjedisi, që shpeshherë nuk vijnë ose nuk vijnë të tria bashkë. Pra, të thuash “ruajtja e produkteve”, është diçka tepër e përgjithshme, e cila duhet saktësuar, sepse përndryshe do të dënoheshin njerëzit pa të drejtë, edhe pse nuk janë në shkelje të ligjit.

Nisur nga sa thashë, pa dashur të shtoj komente, mendimi ynë është që ka vend për të forcuar masat administrative. Ne jem gati me propozimet, për të saktësuar ashpërsimesh që i mendojmë të arsyeshme, dyfishime apo trefishime të gjobave, aty ka vend për ta bërë këtë.

Nga ana tjetër, do të qëndronim për dënime, që do të parashikoheshin në Kodin Penal për disa shkelje të një lloji tjetër për shembull, për importin gjë që nuk është. Themi: “Paraqitja e dokumenteve të falsifikuara për origjinën, përbërjen dhe skadencën e produkteve dënohet me 1-3 vjet burg. Në rast përsëritje dënohet me 5 vjet burg.” Për raste të tilla ne menduam se duhet të ndërhyjmë në Kodin Penal. Nuk e di në jam i qartë për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi dakord me ashpërsimin e dënimit. Nuk parashikohet qartë në ligjin ekzistues dhe ne jemi dakord të vendoset. U mundova të ndaj dy raste: rastin e pakos së skaduar në një supermarket dhe rastin e një shkeljeje, të një dëmi që bëhet me ndërgjegje të plotë dhe në keqbesim të të gjithëve.

Unë i kam renditur të gjitha propozimet në këto 3 faqe. Se cilën do të konsideroni ju, kjo mbetet në gjykimin tuaj. Ne i kemi renditur të gjitha.

Tjetër gjë që do të thosha: propozohet nga ligjbërësit që thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për bllokimin e produkteve të ndryshme jo konform, qëndron. Le të vendosen dënimet e parashikuara edhe për shkelje të tilla. Thelbi është të diferencojmë të dy llojet e shkeljeve. Siç do të propozojmë edhe forcimin e masave ndëshkuese për veprimtaritë prodhuese pa leje, të cilat sot dënohen relativisht butë. E përsëris, unë do t’i depozitoj të gjitha opinionet dhe ju do të shihni se çfarë gjykoni të drejtë të merrni në konsideratë.

Do të shtoja një konsideratë të fundit ndaj gjykimit të zotit Peleshi, që jo gjithçka zgjidhet me masa administrative të marra në situata emergjente. Ka nevojë për masa strukturore, deri shkencore që të bëjmë që sistemi të funksionojë më mirë. Kur flas për sistemin, kam parasysh organet e inspektimit. Sot inspektimi në Shqipëri, ajo që e AKU, është një institucion që funksionon në një farë mënyre, por nuk mund të themi se funksionon në mënyrë shkencore. Unë nuk dua të ndalem këtu, por AKU-ja në origjinë duhet të ishte një institucion që të kishte një drejtori të monitorimit të riskut, pra që të studioje me një monitorim të riskut në të gjithë sistemin nga importi deri te prodhimi i produkteve ushqimore, ku duhet të drejtohen kontrollet dhe si duhet të bëhen këto kontrolle. Duhej të kishte një organ të dytë, i cili është ai i inspektimit.

E para, pa bërë monitorimit të riskut, nuk mund të pretendojmë të kemi eficiencë në inspektimin e riskut. Pra, e them këtë vetëm për të vënë pikën mbi i, sepse ka nevojë për një riorganizim shkencor të organeve të kontrollit. Ministria po përgatit sot adaptimin e rregullores

europiane për inspektimin që do të ishte mirë të hynte sa më shpejt në fuqi për të ndihmuar të gjithë këtë proces.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Leka!

Fjalën e ka zoti Zusi!

Alban Zusi – Mirëdita!

Faleminderit për ftesën!

E vlerësojmë shumë ndërhyrjen që po bëhet në Kodin Penal për të rritur sigurinë ushqimore. Kjo është pa diskutim një ndër çështjet që shqetëson më shumë çdo qytetar të këtij vendi. Mënyra si ka qenë e konceptuar apo si ka qenë e përshkruar deri tani përgjegjësia penale për operatorët, që i hedhin në treg produktet e pasigurta ka qenë e tillë që nuk ka mundur dënimin e operatorëve, të cilët duhet të dënohen për veprat e tyre, pasi konceptimi aktual është i tillë që vepra penale kryhet vetëm nëse dikush vdes, apo nëse do të vërtetohet cenimi i rëndë i shëndetit. Këto janë relativisht të rralla dhe të pamundura për t'u kapur. Ndërkohë, operatorët e biznesit kanë përgjegjësi edhe për disa raste të tjera.

Nga ana tjetër, mënyra se si janë konceptuar modifikimet e reja krijojnë një dizekuilibër total në fushën e biznesit duke e bërë pothuajse të pamundur veprimtarinë ekonomike të biznesit të operatorëve, sepse çdo operator është i kërcënuar për të hyrë së paku një herë në jetë në burg, nëse ushtron aktivitet në fushën e biznesit ushqimor. Edhe ne i kemi të sistemuara arsyetimet tona edhe mbi bazën e jurisprudencës, të drejtës ligjore jo vetëm vendase, por edhe asaj të huaj dhe i kemi depozituar pranë sekretarisë së parlamentit.

Shkurtimisht për të nderuarit deputetë, unë do të ndalem vetëm në 5 parimet kryesore, të cilat duhet të përshkrijnë formulimin e neneve mbi përgjegjësinë penale të operatorëve të biznesit.

Së pari, duhet të vërtetohet ana subjektive, pra të ndahet me dashje apo pa dashje hedhja në treg e produkteve të pasigurta. Kjo për faktin se siç e tha më përpara zoti Leka, nëse një operator biznesi importon një produkt me probleme ose me origjinë të ndryshuar, apo me dokumente të falsifikuara, atëherë operatori kryen një vepër penale që duhet të ndëshkohet.

Nëse operatori nuk ka asnjë dijeni për produktin, për problemet që ai mund të ketë apo jemi në rastet e një aksidenti teknologjik, të cilat ndodhin, e kam thënë edhe në raste të tjera me mediet, që ka një *website* të posaçme të FDA-së dhe të USDA-së amerikane në të cilat çdo ditë

ka mbi 5-6 njoftime të kompanive, që njoftojnë konsumatorin dhe autoritetet që iks produkt, i iks kompanie, me iks Lot. duhet të tërhiqet nga tregu dhe të mos blihet nga konsumatori për shkak të dyshimeve apo të problemeve këtu apo atje. Pra, aksidentet mund të ndodhin. Kompani shumë të mëdha europiane tërhoqën para pak kohe, qumështin për fëmijë dhe nuk pati ndonjë administrator të këtyre kompanive të burgosur. Ne jemi dëshmitarë për këtë.

Elementi i dytë është marrja e masave, nëse subjekti ka hedhur në treg produkte të pasigurta, përsëri në bazë të ligjit europian të përgjegjshmërisë së prodhuesit mbi produktin e tij, duhet që operatori të vërtetojë që ka ndërtuar një sistem për të parandaluar problemin, ka trajnuar personelin për ta parandaluar problemin dhe ka bërë analizat rregullisht sipas parashikimeve ligjore. Nëse këto 3 kushte janë të plotësuar, automatikisht prodhuesi, operatori çlirohet nga përgjegjësia për produktin e dalë aksidentalisht në treg.

Në qoftë se operatori nuk i ka plotësuar këto, atëherë i bie që ai të jetë përgjegjës që operon në kushtet e një sipërmarrjeje që nuk i parandalon aksidentet.

Së treti, përgjegjësia duhet të jetë individuale dhe jo automatikisht e administratorit të kompanisë.

Në rast se ne nuk e ndajmë qartë këtë parim, atëherë secili prej administratorëve është i kërcënuar për të hyrë në burg, sepse konkurrenti do të korruptojë një punonjës të tij, i cili do të krijojë një aksident teknologjik, do ta hedhë në treg, do të marrë 10 milionë lekë nga konkurrenti dhe do t'ia arrijë të fusë administratorin konkurrent në burg.

Pika 4, kur subjekti vetë konstaton se ka një problem me produktin e tij dhe i njofton autoritetet dhe konsumatorin për ta hequr produktin nga tregu. Edhe për këtë rast nuk duhet të ketë asnjë lloj përgjegjësie për operatorin, sepse vetë ai ndërhyr vetë në treg, njofton dhe merr masat për të minimizuar efektet, që mund të vijnë nga një produkt i pasigurt. Ekziston rreziku që të na ndodhë shpesh që edhe kur i çojmë analizat për një autokontroll se kemi një dyshim, bëhemi objekt dhe subjekt i kontrolleve të ekzagjeruara nga AKU-ja për shkak të një sistemi të konceptuar në këtë mënyrë. Imagjinoni nëse kemi edhe një formulim evaziv në Kodin Penal që ti e ke hedhur produktin në treg, është i pasigurt, është vërtetuar në këtë mënyrë, sipas parashikimit vepra penale dhe pavarësisht se ti e ke tërhequr vetë, rrezikon të bësh burg. Kjo vë në pikëpyetje operatorin, nëse duhet të njoftojë, apo jo për produktin e pasigurt.

Së fundi, duhet të kuptojmë që siguria ushqimore është një medalje me dy anë. Është biznesi nga njëra anë dhe institucionet publike nga ana tjetër.

Nëse ne kemi veterinerë bashkish apo veterinerë publikë, që shkojnë dhe certifikojnë mish në thertore pa asnjë lloj dokumentacioni, ata pa diskutim, janë duke hedhur në treg produkte të pasigurta. Në këtë rast Kodi Penal duhet të parashikojë masa edhe për këtë kategori të operatorëve të rrjetit dhe të zinxhirit ushqimor.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kanë ndonjë gjë për të shtuar përfaqësuesit e tjerë?

Zonja Gjeçi, nga ministria, a doni të shtoni diçka për ato që thanë grupet e interesit?

Ermira Gjeçi – Mirëdita të gjithëve!

Kërkoj ndjesë për vonesën në komision!

Në lidhje me pretendimet që kanë shoqatat e biznesit, janë zhvilluar disa takime me grupet e interesit me Ministrinë e Bujqësisë, janë depozituar opinionet e tyre pranë grupit të punës në ministri, i cili merret me hartimin dhe draftimin. Janë marrë në konsideratë. Ndërkohë, janë depozituar materiale edhe nga Shoqata e Konsumatorëve. Disa prej propozimeve që kanë sjellë shoqatat janë konsideruar dhe janë bërë ndryshimet e duhura në projektligjin përfundimtar, i cili është depozituar pranë këtij komisioni.

Unë jam shumë dakord që paralelisht me forcimin e kësaj mase të punohet për rritjen e nivelit të inspektimit ose riorganizimin e AKU-së dhe të akteve nënligjore. Kështu, janë 2 aspektet, 2 lojtarët, që marrin pjesë në këtë sfidë që përballet vendi drejt përmirësimit ose në rastin në fjalë drejt forcimit të masave, që merren ndaj rasteve të evidentuara.

Mbase lidhur me problemet që edhe zoti Leka, edhe zoti Zusi ngritën, unë do të ftoja Kleves Jankun që vjen nga Departamenti Juridik i ministrisë, se si interpretohen nga ana ligjore të gjitha nenet, sepse në informacionin që m'u dha, është që janë shumë të qarta, gjë që do të thotë se hallkat janë të ndara. Nuk gjobitet administratori në momentin që evidentohet atje shkelja, pasi janë: importimi, prodhimi dhe tregtimi i ushqimeve. Në momentin që hetohet një rast kalohet mbrapsh në të gjitha hallkat, duke gjetur subjektin, i cili është pjesë e këtij manipulimi.

Lidhur me pjesën e etiketimit të produkteve ushqimore, jam shumë dakord që kompanitë ose operatorët e biznesit ushqimor kanë në magazinat e tyre mallra të skaduara, të cilat kanë destinacion konfiskimin ose shkatërrimin e tyre. Mbase kjo duhet të qartësohet, ose duhet të jenë të qarta afatet se deri kur lejohet, sepse ka një procedurë që operatorët e biznesit

ushqimor njoftojnë AKU-në për këtë dhe ngrihet ekipi apo komisioni, i cili merret me shkatërrimin e mallrave të shkatërruara.

Niko Peleshi – Dakord.

Së pari, ju falënderoj për të gjitha problematikat e ngritura, të cilat, siç e thanë zoti Sinaj, zoti Baraj dhe të gjithë anëtarët e tjerë janë shumë të vyera për ne, jo sepse kështu e do kortezia e rastit, por ne në komision, e kemi të pamundur të hymë në thellësi të të gjitha implikimeve, pasojave apo impaktit që mund të ketë një ndryshim neni apo ligji, ndërkohë që ju e shihni nga një këndvështrim tjetër, nga një grup i interesuar drejtpërdrejt.

Mënyra se si do të procedojmë për të integruar për sa do të çmohet e nevojshme dhe e drejtë nga ana e komisionit, mendimet tuaja për projektligjin në seancën tjetër për diskutimin në parim dhe sidomos në atë nen për nen komisioni do të paraqesë një matricë në të cilën një kolonë e veçantë do të jetë me opinionet apo me sugjerimet tuaja, pra të të dy përfaqësuesve. Do t'i integrojmë atje dhe kur të diskutojmë nenin, do të diskutojmë variantin e ardhur nga qeveria dhe variantin e propozuar nga Komisioni i Integritetit, nëse ka për ndonjë çështje të caktuar, siç po e diskutojnë tani me këshilltarët e komisionit, për shembull për mjedisin, ku ka nevojë për një përafrim, mund të kalojë nga Komisioni i Integritetit, do të kemi edhe opinionin e komisioneve të tjera. Një kolonë e veçantë do të jetë për opinionin e grupeve të interesit.

Natyrisht, jeni të mirëpritur të vini në mbledhje, sepse ajo është e hapur. Mund të merrni pjesë edhe gjatë diskutimit nen për nen të projektligjit. Ministria do të jetë patjetër e ftuar, por edhe grupet e interesit, zoti Leka, zoti Zusi dhe kushdo tjetër, mund ta ndjekin edhe seancën e shqyrtimit nen për nen, që të na jepni mundësi të konsultohemi para se të vendosim për ta çuar në seancë. Synohet të shkojë shumë shpejt në seancë, nëse do t'ia dalim, mundësisht edhe në datën 6, siç e kemi planifikuar, sepse çmohet që janë ndryshime të nevojshme. Mund të jetë i nevojshëm dhe ka diskutime edhe për rishikimin në tërësi të Kodit Penal, por ky është një proces shumë i gjatë dhe ne nuk mund t'i linim që këto çështje të nxehta të prisnin rrjedhën normale të rishikimit, kur t'i vinte radha Kodit Penal. Kemi marrë shumë ngacmime, nxitje nga grupet e interesit. Ka pasur incidente të ndryshme që kanë ndodhur që na kanë sjellë domosdoshmërinë për propozimin e këtyre ndryshimeve të Kodit Penal, që besoj se duke u kombinuar edhe me punën institucionale, edhe me atë që tha zoti Leka, me modernizimin të qasjes së institucioneve tona drejt menaxhimit të riskut, jo drejt kontrollit të vazhdueshëm e ndonjëherë, të ekzagjeruar, siç e tha zoti Zusi, jo nga dashakeqësia (ndonjëherë edhe nga kjo),

por përgjithësisht ngaqë procedura dhe procesi është i tillë. Pra, kur AKU-ja merr informacion për një devijim dhe për një shkelje të standardit, është e detyruar futet në protokollin e vet dhe duhet të shkojë të skanojë etj. por shpesh kjo është e ekzagjeruar. Për ta shmangur dhe për ta bërë më eficiente ndërhyrjen por edhe për të kursyer energji, ka nevojë për një inxhinieri të re, ka nevojë për qasjen e menaxhimit të riskut që me sa duke i ka ardhur radha, por nuk mund të shkonim, aty zoti Leka (e kemi diskutuar bashkë), nëse nuk do ta shkundnim fillimisht AKU-në nga të gjitha problemet që kishte trashëguar ndër vite, ta kthenim në një forcë që reagon përgjithësisht me integritet dhe të pastruar nga fenomenet e ryshfetit, që më parë kanë qenë një tmerr dhe më pas, ta modernizonin. Unë nuk besoj, se e kemi filluar gabim.

Faleminderit!

Mbledhjen e komisionit e kemi nesër në orën 11:00.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA